



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .....04.2023

Nr: .....

Ora: .....

PROJEKTVENDIM

PËR

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR.1796, QV NR.1796/01, QV NR.1796/02, BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N**

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Në KQZ është administruar propozimi i Administratorit, të autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, të njësisë administrative nr.4, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 3 qendrave të votimit, konkretisht të QV nr.1796, QV nr.1796/01 dhe QV nr.1796/02, nga ambjent privat të z.Robert Bano në ambjent privat të z.Kastriot Isufaj, me arsyetimin që ambjenti i z.Robert Bano nuk plotëson kushtet dhe kriteret e ligjit për të shërbyer për qendër votimi.

Ambienti privat i z.Kastriot isufaj ka shërbyer si qendër votimi edhe në zgjedhjet e kaluara.

Nga verifikimi i kryer në terren nga administrata e KQZ, rezulton e njëjta situatë sikundër referohet nga Administratori i njësisë administrative, ambjenti i z.Roberto Bano nuk ka kushte

Data: ... 04.2023 Nr: .....  
Ora: ....



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.1796, QV nr.1796/01, QV nr.1796/02, bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”

për të shërbyer si qendër votimi (mungesë instalimesh të energjisë elektrike, thuajse në fazë karabina).

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

### **V E N D O S :**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.1796, QV nr.1796/01, QV nr.1796/02, duke i caktuar në ndërtesën private, ambient shërbimi, të z.Kastriot Isufaj.
2. Administratori i njësisë administrative të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Administratori i njësisë administrative të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 3 vjet

K.Nogu \_\_\_\_\_  
B.Kodra \_\_\_\_\_  
E.Meta \_\_\_\_\_  
M.Çelmeta \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Data: .. 04 2023 Nr: .....  
Ora: .....



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.1796, QV nr.1796/01, QV nr.1796/02, bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”